



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 18, datë 06.03.2024

PËR MIRATIMIN PËR NJË SHITESË NË KONTRATËN E QIRASË, QË MBAN NR.12644 PROT., DATË 30.7.2019, E LIDHUR NDËRMJET BASHKISË DURRËS, SI QIRADHËNËS DHE SHOQËRISË “UNIEURO” SHPK, SI QIRAMARRËS, TË SIPËRFAQES SË PËRGJITHSHME 262.6 M², KU SIP. NDËRTIMI 257.7 M² DHE SIP. FUNKSIONALE 5 M² DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR EKONOMINË PËR VAZHDIM PROCEDURE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR PËRFSHIRJEN E SIPËRFAQES SHITESË ME TARIFËN 1 EURO

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, Vendimit nr.54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr. 54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, “Për Qiranë”, kërkesës së subjektit “Unieuro” shpk, që mban nr. 9877, datë 15.12.2023, e protokolluar në Bashki me nr. 11987 prot., datë 15.12.2023, me anë të së cilës kërkon shtesë në kontratën e qirasë me nr. 12644 prot., datë 30.7.2019, për shkak të shtimit të një procesi të ri, si dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për një shtesë në kontratën e qirasë me nr. 12644 prot., datë 30.7.2019, e lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës, si Qiradhënës, dhe Shoqërisë “Uniero” shpk, si Qiramarrës, për pasurinë kufitare me sipërfaqe të përgjithshme 262.6 m², ku sip. ndërtimi 257.6 m² dhe sip.funksionale 5 m², që ndodhet në katin përdhe të ish repartit të URT-së, sipas genplanit dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e kërkesës për t’u drejtuar Ministrisë përgjegjëse për Ekonominë për vazhdim procedure me Këshillin e Ministrave për dhënien e miratimit për përfshirjen e sipërfaqes shtesë me sip. të përgjithshme 262.6 m², ku sip. ndërtimi 257.6 m² dhe sip. funksionale 5 m² me tarifën 1 euro.
3. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.


KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 07.03.2024

Planvendosja e Ambientit kati perdhe SH 1:300




Planvendosja e Ambientit kati i pare SH 1:300



MIRATOI

Pozicioni me hartën kadastrale SH 1:1000



KRYETARI I BASHKISE DURRES
Miriamiriana Sako

DREJTORIA LIGJORE

Ejlo Jani

AMBIENTET E ISH URT

Punoi	E.Kacafi	Specialist
Punoi	A.Murja	Specialist
Aprovoi	P.Cagani	Perg. Sako
Janar 2024		

A-3




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 / Prot.
4

Durrës, më 18.03.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.18 datë 06.03.2024 “Për miratimin për një shtesë në kontratën e qirasë, që mban nr.12644 prot., datë 30.7.2019, e lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës, si qiradhënës dhe shoqërisë “UNIEURO” shpk, si qiramarrës, të sipërfaqes së përgjithshme 262.6 m2, ku sip. ndërtimi 257.7 m2 dhe sip. funksionale 5 m2 dhe miratimin e kërkesës për t’u drejtuar ministrisë përgjegjëse për ekonominë për vazhdim procedure me Këshillin e Ministrave për dhënien e miratimit për përfshirjen e sipërfaqes shtesë me tarifën 1 euro”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

